



VENDIM

Nr.169, Datë 31.10.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA
NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE NR 103 DATË 23.06.2016 , “MBI
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET
E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN
DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR
PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe nenit 16 të Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.10.2016, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me kërkesën e shoqërive “OSHEE” sh.a. dhe OST sh.a. për rishikimin e vendimit të ERE nr 103 date 23.06.2016 “Mbi miratimin e Rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike”

Konstatoi se:

- Mbështetur në nenin 19 gërma l) ERE miraton, me propozim të të licencuarve rregullat për: i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.
- OSHEE sh.a. në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik konstaton vështirësi në implementimin në afat të rregullave të përcaktuara në

Rregullore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, sa i përket ndërtimit të platformës IT.

- Parashikimet e nenit 20 të *Rregullore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik*, mund të adresohen në marrëveshjen që do të lidhet në përfundim të një procedure prokurimi.
- OSHEE sh.a. në shkresën e saj nr. 24041 prot., datë 21.10.2016 drejtuar ERE, ka kërkuar shtryjen e afatit të hyrjes në fuqi të vendimit nr. 103, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE me 60 ditë.
- OST sh.a. është shprehur me shkresën nr. 613 Prot., datë 29.09.2016, protokolluar në ERE me nr. 701 prot., datë 30.09.2016, se OST sh.a. është ende në fazën e implementimit të platformës IT On-line dhe që referuar kontratës përkatëse parashikohet të jetë funksionale në fund të 6 mujorit të parë të vitit 2017.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në nenin 20 të “Rregullores” së miratuar me vendimin e ERE nr. 103, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe

të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

2. Pika nr. 2 e Vendimit 103, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, ndryshon si më poshtë :

- “Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, hyn në fuqi brenda datës 31.01.2017.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., OST sh.a., KESH sh.a., Autoritetin e Konkurrencës dhe MEI për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.